

L I G J¹
Nr. 8869, datë 22.5.2003

PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(Ndryshuar me ligjin nr. 9445, datë 16.11.2005; nr. 10142, datë 15.5.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i misionit, i organizimit të Gardës së Republikës të Shqipërisë dhe i statusit të saj.

Neni 2

1. Garda e Republikës së Shqipërisë është strukturë me status të veçantë në Ministrinë e Brendshme, që ka për mision ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave, të përcaktuara në këtë ligj. Ajo varet nga Ministri i Brendshëm.

2. Misioni dhe statusi i Gardës nuk ndryshojnë në gjendje të jashtëzakonshme apo në gjendje lufte.

Neni 3

Garda e Republikës është person juridik, buxheti i së cilës është zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Brendshme.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr. 9445, datë 16.11.2005)

Garda e Republikës së Shqipërisë ruan dhe mbron:

- a) Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe familjet e tyre;
- b) personalitetet e huaja, të të njëjtit nivel me personalitetet shqiptare të përmendura në shkronjën “a”, që vijnë në vendin tonë, si dhe personalitete të tjera të huaja, për të cilët Ministri i Brendshëm e vlerëson të nevojshme ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre;
- c) personalitetet shtetërore vendase, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ç) rezidencat presidenciale, selinë dhe zyrat e Kuvendit të Shqipërisë, selinë e Këshillit të Ministrave dhe mjediset ku vendosen personalitetet e huaja, të përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni;
- d) banesat e personaliteteve të larta shtetërore dhe seli të tjera shtetërore, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

¹ *Ligj nr. 8869, datë 22.5.2003 është shfuqizuar me ligjin nr. 33/2021, datë 16.3.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.*

Neni 5

(Ndryshuar me ligjin nr. 9445, datë 16.11.2005)

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri ruhen dhe mbrohen edhe 3 vjet pas lirimit të tyre nga funksioni.

2. Personalitetet e tjera shtetërore vendase, të cilat ruhen dhe mbrohen pas lirimit nga funksioni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 vjet pas lirimit nga funksioni.

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr. 9445, datë 16.11.2005)

Garda e Republikës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve gjatë veprimtarive, ku marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe personalitetet e përcaktuara në shkronjat “b” e “c” të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 7

Garda e Republikës kryen ceremonialet me truproja nderi, sipas përcaktimit që bëhet në protokollin e shtetit. Mënyra e kryerjes së shërbimit të truprojës së nderit të Republikës përcaktohet në rregullore të veçantë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

1. Garda përbëhet nga komanda qendrore, drejtori dhe struktura të tjera vartëse.
2. Struktura, organizimi, varësia strukturore dhe limiti organik i Gardës së Republikës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Brendshëm.

Neni 9

Komandanti i Gardës ka autoritetin e plotë të drejtimit e të kontrollit të të gjithë veprimtarisë së Gardës. Ai është përgjegjës para Ministrit të Brendshëm për përgatitjen dhe gatishmërinë e efektivave të Gardës dhe për realizimin e misionit të saj.

Neni 10

1. Komandanti i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Brendshëm. Ai përzgjidhet nga radhët e oficerëve madhorë të karrierës të Gardës dhe të Policisë së Shtetit.

2. Komandanti i Gardës lirohet nga detyra kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj;
- c) dënohet me vendim gjykatë të formës së prerë për një çështje penale;
- ç) tregon paaftësi në përmbushjen e detyrës;
- d) arrin moshën për pension.

Neni 11

1. Punonjësit e Gardës, sipas detyrave dhe funksioneve që kryejnë, kategorizohen në gardistë dhe punonjës të nivelit:

- a) të ulët;
- b) të mesëm;
- c) të lartë;
- ç) madhor.

2. Punonjës të nivelit të ulët janë nënoficerët gardistë, të cilët shërbejnë për ruajtjen e objekteve dhe të personaliteteve.

3. Punonjës të nivelit të mesëm janë oficerët gardistë, të cilët ruajnë dhe mbrojnë personalitetet dhe objektet e përcaktuara në këtë ligj.

4. Punonjës të nivelit të lartë janë oficerët gardistë, drejtues të shërbimeve dhe të strukturave në Gardë.

5. Punonjës të nivelit madhor janë oficerët gardistë, drejtues të Gardës e të strukturave të saj.

Neni 12

1. Në Gardën e Republikës pranohen shtetasit shqiptarë sipas kritereve të mëposhtme:

1.1. Për gardistët:

- a) të kenë arsimin e mesëm;
- b) të mos jenë dënuar penalisht;
- c) të kenë sjellje të mira qytetare;
- ç) të jenë të aftë fizikisht dhe me gjatësi jo më të vogël se 1,75 m.

1.2. Për nënoficerët gardistë:

Përveç kushteve të përcaktuara në pikën 1.1 të këtij neni, duhet të kenë kryer shërbimin ushtarak, të jenë diplomuar në Institutin e Policisë ose në kurse të barasvlershme me të dhe të pranojnë nënshkrimin e kontratës.

1.3. Për oficerët gardistë:

a) Të jenë diplomuar në Akademinë e Policisë, në Akademinë e Mbrojtjes, ose të jenë me arsim të lartë civil për specialitete të veçanta.

b) Të nënshkruajnë kontratën e pranimit.

1.4. Për oficerët e lartë të Gardës:

Përveç kritereve që parashikohen në pikën 1.3, të kenë kryer kurse kualifikimi, në përputhje me funksionin që do të kryejnë.

1.5. Në sektorët mbështetës dhe në ato administrative të Gardës punësohen edhe persona, të cilët trajtohen sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” apo sipas Kodit të Punës.

Neni 13

Efektivi i Gardës së Republikës betohet sipas kësaj formule betimi:

“Si pjesëtar i Gardës së Republikës betohem se do të jem besnik i popullit tim, trim, i disiplinuar, se do të zbatoj kërkesat e Kushtetutës e të ligjeve dhe do të jem i gatshëm përherë, duke mos kursyer as jetën, për kryerjen e detyrës. Ndëshkimi më i rëndë i ligjeve le të më jepet, nëse shkel këtë betim solemn! Betohem!”.

Neni 14

1. Punonjësi i Gardës largohet nga Garda dhe kalon në rezervë kur:

a) mbush moshën për pension;

b) bëhet i paaftë për punë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj me vendim të komisionit mjekësor ose të gjykatës;

- c) shkurtohet funksioni ose për shkak të ndryshimeve në organikë;
- ç) kërkon ai vetë, pasi ka plotësuar kushtet e kontratës së pranimi.

2. Punonjësi i Gardës përjashtohet nga Garda kur:

- a) kryen, në mënyrë të përsëritur, thyerje të rënda të disiplinës;
- b) nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyetuara, mbi 7 ditë;
- c) shkel betimin;
- ç) është jashtë kriterëve të përcaktuara në këtë ligj;
- d) dënohet penalisht.

3. Marrëdhëniet e punës, të karrierës dhe të ndërprerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e personelit të Gardës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

4. Emërimi dhe shkarkimi i oficerëve madhorë të Gardës bëhet nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Brendshëm.

5. Emërimi dhe shkarkimi i oficerëve të lartë të Gardës bëhet nga Ministrit të Brendshëm me propozimin e Komandantit të Gardës.

6. Emërimi dhe shkarkimi i oficerëve të nivelit të mesëm dhe i nënoficerëve gardistë bëhet nga Komandanti i Gardës.

Neni 15

Në Gardën e Republikës funksionon hierarkia e gradave, rregullimi i të cilave bëhet me ligj të veçantë.

Neni 16

Punonjësit e Gardës ndëshkohen me këto masa disiplinore:

- a) vërejtje;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) gjobë në masën e pagës deri në 5 ditë pune;
- ç) shtyrje e afatit të gradimit deri në një vit;
- d) ulje në detyrë ose në funksion;
- dh) pezullim nga detyra ose nga funksioni deri në 3 muaj, ose deri në përfundimin e çështjes penale;
- e) përjashtim nga Garda e lirim, sipas pikës 2 të nenit 14.

Neni 17

1. Punonjësi i Gardës i nënshtrohet zbatimit të rregullores së disiplinës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Në Gardë, me urdhër të Ministrit të Brendshëm, ngrihet dhe funksionon komisioni disiplinor.

Neni 18

1. Punonjësit e Gardës së Republikës i kryejnë detyrat e tyre me uniformë dhe mbajnë shenjat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Uniforma dhe shenjat dalluese përdoren vetëm gjatë kryerjes së detyrës.

2. Shërbime të veçanta të Gardës, të përcaktuara nga Ministri i Brendshëm, i kryejnë detyrat me veshje civile ose veshje të përshtatshme, sipas natyrës së shërbimit.

3. Punonjësi i Gardës pajiset me dokument zyrtar identiteti, të cilin e përdor vetëm për shkak të detyrës.

4. Punonjësi në rezervë i Gardës ka të drejtë të përdorë uniformën në raste festash zyrtare

dhe ceremonish.

Neni 19

Punonjësit e Gardës i nënshtrohen juridiksionit penal të zakonshëm.

Neni 20

1. Punonjësi i Gardës së Republikës, në shërbim ose për shkak të shërbimit, është i paprekshëm. Fyerjet, kundërshtimet dhe çdo veprim i dhunshëm ndaj tij dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

2. Kur punonjësit të Gardës, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja a prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Mënyrat e mbrojtjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Punonjësi i Gardës, gjatë kryerjes së detyrës, përdor edhe forcën fizike ose mjete teknike të posaçme për të neutralizuar ose për të shmangur persona të veçantë ose grup personash, që nuk u binden kërkesave të tij e që përbëjnë rrezik ose pengojnë kryerjen e shërbimit për ruajtjen e personaliteteve a të objekteve që parashikohen në këtë ligj.

Neni 22

Punonjësit e Gardës, gjatë kryerjes së detyrës, kanë të drejtë të bëjnë verifikimin e identitetit, kontrollin fizik të mjeteve dhe të bagazheve të të gjithë personave që hyjnë në objektet në ruajtje.

Neni 23

Për nevojat e sigurisë ose në kushtet e nevojës ekstreme ndaj personaliteteve të larta shtetërore të vendit dhe të huaja, si dhe gjatë veprimtarive të caktuara, punonjësit e Gardës, vetë a në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor ose me Policinë e Shtetit, bllokojnë pjesë rrugësh a mjedise publike për aq kohë sa është e nevojshme.

Neni 24

1. Punonjësit e Gardës, që kryejnë detyrën e ruajtjes nga afër të personaliteteve, i kërkojnë punonjësit të policisë të bëjë identifikimin dhe shoqërimin e personave të dyshuar.

2. Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës rregullohet me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

Neni 25

Punonjësi i Gardës përdor armën në rastet e përcaktuara në ligjin nr.8290, datë 24.2.1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, si dhe në rastet kur sulmohen:
personalitetet e larta shtetërore të vendit dhe të huaja;
rojet dhe objektet në ruajtje.

Neni 26

Për kryerjen e detyrave, punonjësi i Gardës pajiset me armatim dhe mjete teknike të posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Subjektet private dhe shtetërore janë të detyruara t'i lejojnë punonjësit e Gardës së Republikës që të kryejnë detyrat për mbrojtjen e personaliteteve të larta të vendit dhe të huaja, në rastet kur këto personalitete shkojnë pranë këtyre subjekteve, për veprimtari pune ose pushimi. Në këto raste, punonjësi i Gardës që kryen këtë detyrë identifikohet si i tillë.

Neni 28

1. Shërbimet informative dhe ato të Policisë së Shtetit detyrohen t'i japin të dhëna Gardës për një rrezik të mundshëm ndaj personaliteteve të larta shtetërore a ndaj objekteve.

2. Rregullat për shkëmbimin e të dhënave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe titullarëve përkatës.

Neni 29

Zyrat e protokollit dhe kabinetet e personaliteteve detyrohen të njoftojnë Gardën e Republikës jo më vonë se 24 orë përpara për veprimtarinë e personaliteteve të larta shtetërore të vendit ose të huaja.

Neni 30

Punonjësi i Gardës nuk mund të dypunësohet ose të kryejë veprimtari private.

Neni 31

1. Punonjësi i Gardës, në çdo rrethanë, nuk duhet të sillet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës.

2. Punonjësit të Gardës i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike.

3. E drejta e punonjësit të Gardës për t'u përfaqësuar në organet e zgjedhura rregullohet me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.

Neni 32

Punonjësve të Gardës u ndalohet të organizohen në sindikata dhe të ushtrojnë të drejtën e grevës, si dhe të bëjnë grumbullime.

Neni 33

1. Koha e punës e punonjësve të Gardës njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike, me përjashtim të përcaktimeve të shprehura në këtë ligj.

2. Pushimi vjetor për punonjësit e Gardës është 30 deri në 45 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar, sipas funksioneve dhe gradave.

3. Kur, për arsye pune a shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai jepet jo më vonë se në muajin shkurt të vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi i tij në vlerë.

4. Punonjësi i Gardës i gëzon këto të drejta edhe në rastet e shërbimit në ditët e pushimeve javore ose në ditët e festave zyrtare.

5. Në rast fatkeqësie familjare, martese ose në raste të tjera të veçanta punonjësit të Gardës i jepet deri në 7 ditë leje e pagueshme ose deri në 2 muaj leje pa të drejtë page.

6. Periudha e lejes pa të drejtë page nuk llogaritet në vjetërsi pune a shërbimi dhe as për efekt të ecurisë në gradë.

7. Kriteret dhe masat e përfitimeve përcaktohen me akte normative të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 34

1. Punonjësi i Gardës, për shkak të përgjegjësisë, vështirësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, ka përparësi në trajtimin me pagë.

2. Paga e punonjësit të Gardës caktohet në varësi të rolit dhe të gradës që ka fituar, funksionit që kryen, shkallës së rrezikshmërisë dhe vështirësisë, si dhe në varësi të kushteve të tjera, të veçanta, të vendit të punës, të shërbimit dhe të profesionit.

3. Paga mujore e punonjësit të Gardës përbëhet nga paga bazë, shtesa mbi pagën bazë (në përqindje ose në skemë absolute) dhe kompensimet për privacionet dhe humbjet që i krijohen punonjësit të Gardës për shkak të nevojave të punës e të shërbimit.

4. Paga bazë mujore është fikse dhe përcaktohet sipas funksionit (nivelit) dhe gradës. Punonjësi i Gardës, për natyrë të veçantë shërbimi, përfiton shtesë mbi pagën bazë.

5. Rregullimi i pagave dhe kriteret për dhënien e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

1. Punonjësve të Gardës, për rezultate shumë të larta në stërvitje e gatishmëri, ruajtje e administrim të vlerave materiale e monetare, si dhe kur kryejnë detyra me rreziqe për jetën e tyre, u jepet shpërblim.

2. Kriteret dhe masa e shpërblimit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

1. Punonjësit të Gardës, në rast pamundësie punësimi të bashkëshortes, i jepet ndihmë financiare në raport me pagën minimale në shkallë vendi dhe për fëmijët që ka në ngarkim.

2. Periudha e trajtimit me këtë ndihmë financiare njihet periudhë sigurimi për bashkëshorten.

Neni 37

1. Punonjësi i Gardës, në rast transferimi dhe kur është i pastrehë, përfiton kompensim qiraje banese deri në sigurimin e banesës nga shteti.

2. Masa dhe kriteret e kompensimit përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Punonjësi i Gardës, kur dërgohet për formim dhe kualifikim profesional me shkëputje nga puna mbi 6 muaj, trajtohet me pagën e gradës dhe funksionit që ka.

Neni 39

(Shfuqizuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009)

1. Shfuqizuar.
2. Shfuqizuar.
3. E drejta e përfitimeve suplementare për punonjësit e Gardës varet nga koha (vjetërsia) e shërbimit, paga e realizuar dhe kontributi i paguar.
4. Kohë (vjetërsi) shërbimi për punonjësit e Gardës quhet:
koha nga data e pranimi si kursant ose student;
b) koha e njohur si ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose si efektiv i Policisë së Shtetit;
c) koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të një vendimi të padrejtë;
ç) koha e qëndrimit në dispozicion, për shkak të pritjes për sistemimin në një funksion në përputhje me gradën;
d) gjysma e periudhës së kaluar si punonjës në sektorët civilë dhe periudha e plotë e kaluar si ushtarak, para pranimi si punonjës i Gardës.
5. Paga e realizuar, për efekt të përfitimit nga ky ligj, është paga bazë mujore, së bashku me shtesat me karakter të përheshëm që ka përfituar punonjësi i Gardës.

Neni 40

Punonjësi i Gardës, në rast paaftësie shëndetësore për të shërbyer në Gardë ose kur i shkurtohet funksioni organik, ka përparësi punësimi në administratën publike, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”.

Neni 41

Garda e Republikës ndërton, me fonde shtetërore, apartamente banimi, ku strehohen punonjësit e saj. Apartamentet i marrin me qira, me kushte lehtësuese, sipas udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Neni 42

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve të nxjerrë aktet nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji sipas neni 4 shkronja “ç”, nenit 5 pika 2, nenit 7, nenit 8 pika 2, nenit 14 pika 3, nenit 17 pika 1, nenit 18 pika 1, nenit 20, nenit 26, nenit 33, nenit 34 pika 5, nenit 35, nenit 36, nenit 37 pika 2 dhe nenit 39.

2. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë aktet sipas nenit 17 pika 2, nenit 18 pika 2 dhe nenit 24 pika 2.

Neni 43

Ligji nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me të gjitha ndryshimet e bëra në të, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.